



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 98/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh...O... Sh.p.k me nr. të biznesit ... me seli në Rahovec, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat E.G. nga Prizreni kundër debitorit K...B... Sh.p.k, me nr. të biznesit ..., me seli në Malishevë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 134/18 të datës 17.05.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, me zyre në Prizren, jashtë seancës, me datë 15.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit K...B... Sh.p.k me seli në Malishevë ashtu që ANULOHET Urdhri përmbartimor P.nr. 134/18 i datës 17.05.2018 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani me seli në Prizren.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Sh...O... Sh.p.k me seli në Rahovec, ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 134/18 të datës 17.05.2018, me të cilin ka lejuar prapësimin në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave nr. 01/2018 të datës 02.02.2018 dhe faturës 02/2018 të datës 23.04.2018 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 44,553.73 € (katër dhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre euro e shtatëdhjetë e tre euro cent) me kamatë ligjore prej 8% si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar prapësimi nuk kanë tipare të prapësimshëmërisë kjo sepse faturat në fjalë janë kundërshtuar nga ana e debitorit përmes komunikimit me postës elektronike dhe se kreditori me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë se ka kryer ndonjë shërbim për debitorin e që në këtë rast do mund të faturohej

debitori. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Faturat nr. 01/2018 e datës 02.02.2018 dhe nr. 02/2018 e datës 23.04.2018, në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit si në faturë, dhe përkundër dorëzimit të këtyre faturave nga kreditori përmes email-it, debitori ka kundërshtuar pranimin e këtyre faturave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo faturë, andaj Gjykata vlerëson se faturat e lartcekura nuk janë të përshtatshme për përmbarim përderisa nuk janë të nënshkuara nga debitori dhe nuk është pranuar detyrimi që rrjedh nga fatura.

Po ashtu Gjykata gjeti se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk e përmbajnë në mënyrë të qartë kredinë që kërkohet të realizohet, pasi që nuk specifikohen shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, por vetëm një përshtatshëm të përgjithshëm *“përmbushje e obligimit”*, e mbi këtë bazë nuk tregohet objekti i detyrimit ashtu siç përcaktohet me nenin 27, par.3 të LPP-së.

Gjykata pati parasysh pretendimin e debitorit se faturat e lëshuara për kreditorin burojnë nga Marrëveshja e llogarive të arkëtueshme e datës 23.01.2018, pjesë e shkresave të lëndës, ku kreditori ka marrë obligim që të paguaj 30% të faturës në emër të shërbimeve të transportit që debitori ofron për palët e treta, por pretendimin në fjalë e vlerësoj si të pabazuar, pasi që kreditori ka dështuar të sjellë prova në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së përmes të cilave do mund të vërtetohej se i njëjti ka kryer shërbimet e transportit për palët e treta, dhe se ka lindur detyrimi i debitorit që të financoj 30% të vlerës së këtyre shërbimeve si në shumën e paraqitur në faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi.

Nga të lartcekurat, Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilat Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 98/22, datë 15.03.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.